



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL) nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014 me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të dt. 22.03.2018, si dhe në zbatim të nenit 10, 12, 34, 35 dhe 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës së Gjiçanit merr këtë:

V E N D I M

PËR THJESHTËZIMIN E PROCEDURAVE GJATË LËSHIMIT TË DOKUMENTEVE NË KOMUNËN E GJILANIT

1. Me këtë Vendim synojmë zbatimin e lehtësirave procedurale, thjeshtëzimin e procedurave administrative dhe uljen e kostos financiare gjatë aplikimit dhe lëshimit të dokumenteve të cilat ofrohen nga drejtoritë përkatëse të komunës së Gjiçanit.
2. Në të gjitha rastet kur qytetari bën kërkesë për një dokument, për nxjerrjen e të cilit kërkohet një dokument tjetër mbështetës që lëshohet nga e njëjta drejtori apo drejtori tjetër brenda komunës, zyrtari përgjegjës obligohet që dokumentin e tillë të mos e kërkoj nga qytetari por ta sigurojë nga sistemi i brendshëm elektronik dhe t'ia bashkëngjisë dosjes.
3. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si kopje, atëherë zyrtari përkatës kërkon dokumentin për shikim nga pala, dokumenti kopjohet nga ana e zyrtarit dhe vendoset në dosje. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si origjinal, atëherë zyrtari përkatës e nxjerr dhe e vendos në dosje, por nuk e kërkon nga pala.
4. Të gjitha shërbimet administrative për nxjerrjen e të cilave kërkohen dokumente mbështetëse që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër të komunës janë të paraqitura në Shtojcën 1 të këtij Vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi dhe zbatohet nga data 01 janar 2025.
6. Vendimi u dërgohet të gjithë drejtorive komunale që ofrojnë shërbimet, sipas Shtojcës 1. Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës së Kryeministrit.



Shtojca 1: Shërbimet e thjeshtuara të Komunës së Gjilanit

Nr.	EMRI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	EMRI I DOKUMENTIT QË NUK KËRKOHEM PËR MARRJEN E SHËRBIMIT PËRKATËS
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME		
1	Korrigjimi i emrit personal	1. Certifikatë e martesës së prindërve 2. Vërtetim nga arkiva
2	Ndryshimi i emrit personal	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2. Certifikata e vendbanimit të prindërve (nëse kërkesa është për persona te mitur) 3. Vërtetim nga arkivi
3	Regjistrimi i mëvonshëm i lindjeve	1. Ekstraktet e lindjes së prindërve 2. Vërtetimi që nuk është regjistruar lindja 3. Certifikata e martesës
4	Kurorëzimet	1. Ekstraktet e lindjes 2. Certifikata e statusit martesor
5	Akti i vdekjes	1. Ekstraktet e lindjes për personat në jetë
6	Regjistrimi i mëvonshëm i vdekjeve	1. Ekstrakti i lindjes së të vdekurit 2. Vërtetimi që nuk është regjistruar vdekja
7	Ndryshimi i deklaratës së bashkësisë familjare	1. Deklaratën nën betim te noteri
DREJTORIA E GJEODEZISË DHE KADASTRIT		
8.	Regjistrimi i pronësisë në bazë të transaksioneve	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë i shitësit dhe blerësit
9	Regjistrimi i pronësisë në bazë të ndërrimit/këmbimit të pronës së paluajtshme	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë i shitësit dhe blerësit
10	Regjistrimi i pronësisë apo posedimit në bazë të trashëgimisë	1. Kopjet e letërnjoftimit të personave që paraqesin kërkesën 2. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë i shitësit dhe blerësit
11	Azhurnimet në sektorin e gjeodezisë	1. Certifikatën e pronës 2. Licenca e gjeodetit/Kompanisë gjeodezike 3. Letërnjoftimi i gjeodetit

DREJTORIA E ARSIMIT		
12	Aplikimi për përfitimin e bursave studentore	1.Certifikata e vendbanimit
13	Aplikimi për regjistrim të fëmijës në klasën e parë	1.Certifikatat e prindërve 2.Kopja e faturës së energjisë elektrike
DREJTORIA E URBANIZMIT		
14	Leje ndërtimore kategoria I	1.Vërtetimi i tatimit në pronë 2.Incizimi gjeodezik i parcelës kadastrale
15	Leje ndërtimore – kategoria II	1.Incizimi gjeodezik i parcelës kadastrale 2.Vërtetimi i tatimit në pronë
DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE		
16	Regjistrim në skemën e ndihmës sociale	1.Certifikatat e lindjes të të gjithë anëtarëve 2.Certifikatat e vdekjes së prindërve të fëmiut 3.Certifikata e martesës së prindërve 4.Deklarata e bashkësisë familjare 5.Fleta poseduese
17	Përcaktimi i kujdestarit ligjor të fëmiut	1.Certifikata e vdekjes së prindit 2.Ekstrakti i lindjes së fëmiut
18	Verifikimi i rasteve me asistencë sociale	1. Certifikatë që nuk posedon pronë
DREJTORIA PËR SHERBIME PUBLIKE		
19	Kërkesa për leje varrimi ose zhvarrimi	1. Certifikata e vdekjes
20	Kërkesë për marrjen e lejes për parkim të rezervuar	1. Lejen e vjetër
DREJTORIA E BUJQËSISË		
21	Aplikimi për ndarjen e Subvencioneve Komunale në Bujqësi	1. Fleta poseduese e pronës 2. Certifikata e lindjes
22	Certifikata e regjistrimit të fermerëve	1. Certifikata e lindjes